

Vendim nr. 188 datë 19.09.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Illir Toska, Anëtar

në datën 19.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 11 (S) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: SULEJMAN SEFERAJ, përfaqësuar nga avokat Saimir Vishaj, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 1721, datë 31.10.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; nr. 00-2024-489, datë 19.03.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 512 e vijues të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*); neni 68 i Kodit Penal (*KP*); nenet 27, 50/4, 51/a, paragrafi 1/b, 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin penal nr. 1027/2012, datë 03.04.2012 të Gjykatës së Apelit Bari, Itali (*vendimi penal i huaj i Gjykatës së Apelit Bari, Itali*), kërkuesi Suleman Seferaj është deklaruar fajtor dhe dënuar përfundimisht me 13 vjet e 6 muaj burgim për kryerjen e veprave penale “Shkelja e ligjit mbi drogat” dhe “Organizata kriminale”, të parashikuara nga dispozitat e Kodit Penal italian, pasi në bashkëpunim me persona të tjerë, përgjatë viteve 1997 - 1998, në zonën e Altamurës dhe përreth saj, u kanë dhënë personave të tretë lëndë narkotike (heroinë, kokainë e marijuanë), përveçse në bashkëpunim me një shtetas tjetër, në datën 23.01.1998, kanë mbajtur rreth 5,7 kg lëndë narkotike të llojit marijuanë. Me vendimin nr. reg.gen. 3516/2013, datë 15.04.2014, Gjykata e Kasacionit e Italisë ka vendosur mospranimin e rekursit të ushtruar ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Bari, Itali.

2. Për ekzekutimin ndaj kërkuesit të vendimit penal të Gjykatës së Apelit Bari, Itali, autoritetet e drejtësisë italiane kanë nxjerrë urdhrin nr. 265/2014 SIEP, datë 10.05.2016 (*urdhri i ekzekutimit*), sipas të cilit kërkuesi duhet të vuante dënimin e mbetur prej 6 vjetësh, 7 muajsh e 7 ditësh burgim. Në kushtet kur ekzekutimi i vendimit të dënimit me burgim nuk është arritur të kryhet në territorin e shtetit italian, autoritetet e drejtësisë së këtij të fundit e kanë shpallur kërkuesin në kërkim ndërkombëtar, me qëllim ekstradimin e tij në Itali për vuajtjen e dënimit të mbetur me burgim.

3. Në datën 09.03.2023 oficeri i Policisë Gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë ka kryer arrestimin e përkohshëm të kërkuesit për qëllime ekstradimi në Itali. Materialet e arrestimit të përkohshëm të kërkuesit i janë dërguar Prokurorisë së Përgjithshme, e cila ia ka kaluar ato për veprim Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në vijim, mbi kërkesën e prokurorit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 519, datë 12.03.2023, ka vleftësuar të ligjshëm arrestimin e përkohshëm të kërkuesit për qëllime ekstradimi, duke caktuar ndaj tij masën e sigurimit personal “Arresti në burg”. Ministria e Drejtësisë së Republikës

së Shqipërisë, me shkresën nr. 1037/2 prot., datë 17.03.2023, ka autorizuar mbajtjen e masës së sigurimit “Arresti në burg” ndaj kërkuesit.

4. Pas njoftimit për arrestimin e përkohshëm të kërkuesit për qëllime ekstradimi, autoritetet e drejtësisë italiane kanë kërkuar njohjen dhe ekzekutimin në Shqipëri të vendimit penal të Gjykatës së Apelit të Barit, Itali në lidhje me kërkuesin, në zbatim të urdhrin të ekzekutimit, për pjesën e pavuajtur të dënimit me burgim, si dhe mbajtjen e tij nën arrest, me qëllim fillimin e procedurës së njohjes së vendimit në funksion të vazhdimin të ekzekutimit të vendimit penal italian në Shqipëri.

5. Pasi kërkesa e autoriteteve të drejtësisë italiane i është përcjellë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kjo e fundit i ka kërkuar gjykatës njohjen dhe ekzekutimin në Shqipëri të vendimit penal të huaj të Gjykatës së Apelit Bari, Itali për sa i përket shtetasit Sulejman Seferaj, me të cilin ai është deklaruar fajtor dhe dënuar me 13 vjet e 6 muaj burgim, ndërsa i kanë mbetur pa vuajtur 6 vjet, 7 muaj e 7 ditë burgim.

6. Me vendimin nr. 481, datë 31.05.2023, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së prokurorit për njohjen dhe ekzekutimin në Shqipëri të vendimit penal të huaj të Gjykatës së Apelit Bari, Itali, si dhe ka urdhëruar shuarjen e masës së sigurimit “Arresti në burg” dhe lirimim e menjëhershëm të kërkuesit nga paraburgimi. Sipas gjykatës së shkallës së parë, nga vlerësimi i rrethanave konkrete të çështjes në raport me ligjin e zbatueshëm, rezulton se nuk përmbushen në mënyrë kumulative dy prej kushteve të parashikuara nga neni 514, pika 1, shkronja “c”, i KPP-së dhe neni 54, shkronja “b”, i ligjit nr. 10193, datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, të ndryshuar (*ligji nr. 10193/2009*). Sipas saj, ekzistojnë dyshime të pasqaruara se ndaj të dënuarit Sulejman Seferaj nuk është zhvilluar proces i rregullt ligjor në lidhje me të drejtën e aksesit në gjykatë dhe të drejtën e mbrojtjes në gjykim, dhe se dënimi penal i dhënë ndaj këtij shtetasi me vendimin penal të huaj të Gjykatës së Apelit Bari, Itali mund të jetë parashkuar. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim prokurori.

7. Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 1721, datë 31.10.2023, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë duke vendosur njohjen dhe dhënien fuqi për zbatim në Republikën e Shqipërisë të vendimit penal të huaj të Gjykatës së Apelit Bari, Itali të dhënë ndaj shtetasit shqiptar Sulejman Seferaj dhe konvertimin e dënimit të caktuar me këtë vendim sipas dënimeve të parashikuara nga ligji penal shqiptar për veprën “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të kryer në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, të parashkuar

nga nenet 283, në lidhje me nenet 28, paragrafi 1, 333 dhe 334, paragrafi 1, të KP-së, me 6 vjet, 7 muaj e 7 ditë burgim. Sipas gjykatës së apelit, gjykata e shkallës së parë ka gabuar kur vendimmarrjen e saj e ka bazuar në dyshime. Nga ana tjetër, sipas saj, në rastin konkret nuk ekzistojnë pengesa ligjore për njohjen e vendimit penal të huaj objekt gjykimi. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-489, datë 19.03.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, duke i vlerësuar shkaqet e ngritura në të si haptazi të papranueshme/të pabazuara.

9. Në datën 19.06.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 02.07.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

10. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjatë procesit gjyqësor të kundërshtuar i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

10.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë respektuar të drejtat procedurale të kërkuesit, ndërsa kanë vendosur njohjen e vendimit penal të huaj të Gjykatës së Apelit Bari, Itali dhe dënuar atë me 6 vjet, 7 muaj e 7 ditë burgim duke u bazuar vetëm në urdhrin e ekzekutimit të vendimit pa pasur në dosjen gjyqësore vendimin e formës së prerë të dënimit të kërkuesit.

10.2. *Së drejtës së mbrojtjes*, pasi Gjykata e Lartë, referuar fakteve dhe çështjeve ligjore të ngritura në rekurs, duhet ta shqyrtonte çështjen në themel me praninë e domosdoshme të avokatit të kërkuesit dhe jo në dhomën e këshillimit.

10.3. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë bërë vlerësim të gabuar të fakteve, duke sjellë si pasojë shkeljen e të drejtave procedurale të kërkuesit. Vendimi penal i huaj i Gjykatës së Apelit Bari, Itali është dhënë në datën 03.04.2012, ndërkohë që kërkuesi është arrestuar në datën 09.03.2023, pra përtej afatit 10-vjeçar të parashkrimit të ekzekutimit nga dita kur vendimi ka marrë formë të prerë dhe për këtë arsye ky vendim nuk mund të zbatohet sipas legjislacionit penal shqiptar. Gjykatat, në kundërshtim me ligjin, kanë marrë si referencë datën kur është nxjerrë urdhri i ekzekutimit të vendimit penal të huaj dhe

jo datën kur ai vendim është marrë. Po ashtu, ndonëse me vendimin penal të huaj kërkuesi është dënuar me 13 vjet e 6 muaj burgim, gjykatat kanë caktuar ndaj tij një dënim prej 6 vjetësh, 7 muajsh e 7 ditësh burgim, pa arsyetuar për mënyrën e përlllogaritjes së një dënimi të tillë, për sa kohë ndodhemi në kushtet e njohjes së vendimit të huaj penal.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

12. Kolegji vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

13. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000.

14. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 19.03.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 19.06.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

15. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës aksesit, kërkuesi ka pretenduar se gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë vendosur njohjen e vendimit penal të huaj duke u bazuar vetëm në urdhrin e ekzekutimit të vendimit pa pasur në dosjen gjyqësore vendimin e formës së prerë të dënimit të kërkuesit. Kolegji vëren se, në thelb, argumenti i kërkuesit ka të bëjë me vlerësimin e provave nga gjykatat e faktit, të cilat kanë arritur në të njëjtat përfundime në lidhje me sa pretendohet prej tij. Nga ana tjetër, kërkuesi nuk tregon se si ky argument lidhet me të drejtën e aksesit. Përmes vendimit të kundërshtuar gjykata e apelit është shprehur në themel për kërkesën e prokurorit që ka vënë në lëvizjen procesin gjyqësor, sikundër edhe për pretendimet e ngritura nga kërkuesi si palë në proces. Edhe Gjykata e Lartë është shprehur për rekursin e kërkuesit, i cili e ka vënë në lëvizje atë. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka parashtruar argumente kushtetuese në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit, për rrjedhojë ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

16. Kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës së mbrojtjes nga Gjykata e Lartë, me argumentin se referuar fakteve dhe çështjeve ligjore të ngritura në rekurs ajo gjykatë duhet ta shqyrtonte çështjen në themel me praninë e domosdoshme të avokatit të tij dhe jo në dhomën e këshillimit. Kolegji vëren se, në thelb, pretendimi i kërkuesit ka të bëjë me vlerësimin e Gjykatës së Lartë për papranueshmërinë për shqyrtimin në themel të rekursit të tij. Për rrjedhojë, ky pretendim do të trajtohej në kuadër të pretendimit tjetër të kërkuesit, atij për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

17. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, Kolegji vlerëson se ky pretendim *prima facie* bën pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të shqyrtohet në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

18. Sipas kërkuesit, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë bërë vlerësim të gabuar të fakteve, duke sjellë si pasojë shkeljen e të drejtave procedurale të tij. Sipas tij, vendimi penal i huaj i Gjykatës së Apelit Bari, Itali është dhënë në datën 03.04.2012, ndërkohë që ai është arrestuar në datën 09.03.2023, pra përtej afatit 10-vjeçar të parashkrimit të ekzekutimit nga dita kur vendimi

ka marrë formë të prerë dhe për këtë arsye ky vendim nuk mund të zbatohet sipas legjislacionit penal shqiptar. Gjykatat, në kundërshtim me ligjin, kanë marrë si referencë datën kur është nxjerrë urdhri i ekzekutimit të vendimit penal të huaj dhe jo datën kur ai vendim është marrë. Po ashtu, sipas kërkuarit, ndonëse me vendimin penal të huaj ai është dënuar me 13 vjet e 6 muaj burgim, gjykatat kanë caktuar ndaj tij një dënim prej 6 vjetësh, 7 muajsh e 7 ditësh burgim, pa arsyetuar për mënyrën e përlllogaritjes së një dënimi të tillë, për sa kohë ndodhemi në kushtet e njohjes së vendimit të huaj penal. Gjykata e Lartë, vijon kërkuar, referuar fakteve dhe çështjeve ligjore të ngritura në rekurs, duhet ta shqyrtonte çështjen në themel në praninë e domosdoshme të avokatit të tij.

19. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Gjykata ka pohuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimin nr. 23, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Lidhur me vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit dhe referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, Gjykata ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i dhomës së këshillimit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 27, datë 27.03.2017; nr. 19, datë 19.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Shqyrtimi i çështjes nga dhoma e këshillimit e Gjykatës së Lartë nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 9, datë 26.03.2018; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi i kufizuar i vendimeve të dhomës së këshillimit nuk përbën cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe se një arsyetim i tillë është tregues i faktit që kërkuar nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës (*shih*

vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

21. Nga ana tjetër, Gjykata në mënyrë konstante ka pohuar se interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre, nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi e gjykatës së zakonshme provohet se ka cenuar të drejta kushtetuese të individit, në kuptimin që procesi në tërësinë e tij rezulton haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 34, datë 12.06.2023; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Për sa i takon procesit gjyqësor me objekt njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale të huaja, të parashikuar në nenet 512 e vijues të KPP-së, Gjykata është shprehur se gjykata që shqyrton kërkesën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit penal nuk gjykon çështjen në themel, por verifikon nëse vendimi i huaj plotëson kushtet e njohjes të përcaktuara në nenin 514 të këtij kodi. Nëpërmjet procedurave gjyqësore realizohet njohja e vendimeve penale të gjykatave të huaja, si dhe caktohet dënimi që duhet të vuhet në përputhje me legjislacionin shqiptar për të njëjtin fakt të pranuar nga gjykata e huaj (*shih vendimet nr. 35, datë 01.06.2015; nr. 6, datë 30.03.2004 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në paragrafin 1 të nenit 516 të KPP-së ligjvënësi ka parashikuar mënyrën e konvertimit të dënimit të vendimit penal të huaj. Konkretisht, në këtë dispozitë parashikohet se: “1. Kur bën njohjen e një vendimi të huaj, gjykata cakton dënimin që duhet të vuhet në shtetin shqiptar. Ajo konverton dënimin e caktuar në vendimin e huaj në një nga dënimet e parashikuara për të njëjtin fakt nga ligji shqiptar. Ky dënim duhet t’i përgjigjet nga natyra atij që është dhënë në vendimin e huaj. Masa e dënimit nuk mund të kalojë kufirin maksimal të parashikuar për të njëjtin fakt nga ligji shqiptar.”. Kurse sipas nenit 11 të Konventës Evropiane “Për transferimin e personave të dënuar”, ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 8499, datë 10.06.1999: “1. Në rastin e konvertimit të dënimit zbatohen procedurat e parashikuara nga ligji i shtetit zbatues. Kur bëhet konvertimi i dënimit, organi kompetent: a) duhet t’u përmbahet konstatimeve për faktet kur ato

shfaqen shprehimisht ose nënkuptohen nga vendimi i dhënë nga shteti dënues; b) nuk mund të konvertojë një dënim me burgim në një dënim me gjobë; c) shkurton periudhën e plotë të heqjes së lirisë që vuhet nga personi i dënuar; dhe d) nuk e rëndon dënimin e personit të dënuar dhe nuk është i detyruar t'i përmbahet ndonjë minimumi që mund të parashikojë ligji i vendit zbatues për veprën ose veprat e kryera.”.

24. Në rastin në shqyrtim, Kolegji evidenton se ndërsa është vënë në lëvizje me kërkesën e prokurorit, pas dërgimit të kërkesës përkatëse nga autoritetet e drejtësisë italiane, gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e kërkesës për njohjen dhe ekzekutimin në Shqipëri të vendimit penal të huaj të Gjykatës së Apelit Bari, Itali të dhënë ndaj kërkuesit. Sipas gjykatës së shkallës së parë, nga vlerësimi i rrethanave konkrete të çështjes në raport me ligjin e zbatueshëm, rezulton se nuk përmbushen në mënyrë kumulative dy prej kushteve të parashikuara nga neni 514, pika 1, shkronja “c”, i KPP-së dhe neni 54, shkronja “b”, i ligjit nr. 10193/2009. Sipas saj, ekzistojnë dyshime të pasqaruara se ndaj të dënuarit Sulejman Seferaj nuk është zhvilluar proces i rregullt ligjor në lidhje me të drejtën e aksesit në gjykatë dhe të drejtën e mbrojtjes në gjykim, dhe se dënimi penal i dhënë ndaj tij me vendimin penal të huaj të Gjykatës së Apelit Bari, Itali mund të jetë parashkuar.

25. Konkretisht, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se në dokumentacionin shoqërues të kërkesës evidentohet mungesa e një paraqitjeje shteruese e ecurisë së procedimit penal në kuptim të nenit 55 të ligjit nr. 10193/2009. Sipas saj, në gjendjen që aktet janë, është e pamundur bërja e një vlerësimi në lidhje me respektimin ndaj të dënuarit të garancive themelore për proces të rregullt ligjor. Të dhënat e karakterit procedural të vendosura në dispozicion të gjykatës kanë natyrë skematike dhe të cunguar, çka pamundëson një analizë të mirëfilltë dhe vlerësimin e kriterit të parashkuar nga neni 514, pika 1, shkronja “c”, i KPP-së. Në pjesën hyrëse të vendimit penal të huaj të Gjykatës së Apelit Bari, Itali specifikohet fakti se i pandehuri (i dënuari) Sulejman Seferaj nuk është paraqitur në seancën e datës 03.04.2012, ndërkohë që është e pamundur të verifikohet fakti nëse ai është njoftuar rregullisht për këtë seancë. Po ashtu, sipas gjykatës, është i pamundur edhe verifikimi i faktit nëse të dënuarit i është komunikuar rregullisht vendimi penal i huaj, në kushtet kur në dokumentacionin shoqërues të kërkesës evidentohet vetëm fakti i paraqitjes ankim (rekurs) në Gjykatën e Kasacionit, por pa specifikuar subjektin që e ka paraqitur atë, shkaqet e rekursit, si dhe arsyet mbi të cilat është vendosur mospranimi i tij.

26. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit penal të dhënë nga Gjykata e Apelit Bari, Itali, ndaj shtetasit Sulejman Seferaj, në

referim të nenit 68/b të KP-së, është 10 vjet, ndërkohë që, referuar praktikës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, fillimi i afateve të parashkrimit të ekzekutimit llogaritet nga momenti kur vendimi ka marrë cilësinë e “gjësë së gjykuar”, çka në rastin konkret përkon me datën 15.04.2014 kur Gjykata e Kasacionit e Italisë ka marrë vendimin e mospranimit të rekursit. Megjithatë, arsyeton gjykata, informacioni zyrtar i paraqitur nga prokurori (nëpërmjet ministrit të Drejtësisë) se ndaj vendimit penal të huaj të Gjykatës së Apelit Bari, Itali është ushtruar rekurs, duke mos saktësuar të dhëna të tjera lidhur me subjektin që e ka paraqitur, shkaqet e rekursit dhe shkaqet e mospranimit nga Gjykata e Kasacionit e Italisë, është i pamjaftueshëm për të arritur një konkluzion të saktë dhe tej çdo dyshimi të arsyeshëm lidhur me faktin nëse është parashkruar ose jo ekzekutimi i këtij vendimi. Sipas gjykatës, nëse ndaj vendimit penal të huaj të Gjykatës së Apelit Bari, Itali është ushtruar rekurs vetëm nga të bashkëpandehurit e tjerë për shkaqe personale, ky vendim për shtetasin Sulejman Seferaj mund të ketë marrë cilësinë e *res judicata* menjëherë pas përfundimit të afateve ligjore të parashikuara nga ligji italian për ushtrimin e rekursit. Për pasojë, vijon gjykata, data 15.04.2014 e referuar nga autoritetet juridiksionale italiane si data kur vendimi i Gjykatës së Apelit Bari, Itali ka marrë cilësinë e *res judicata* mund të mos ketë efekt për të dënuarin Sulejman Seferaj, pasi për këtë të dënuar një cilësi të tillë ky vendim mund ta ketë fituar që në vitin 2012, duke pasur kështu dyshime të arsyeshme se ekzekutimi i këtij vendimi është parashkruar që në vitin 2022. Në këtë këndvështrim, arsyeton gjykata, për sa kohë ka paqartësi për datën kur vendimi penal i huaj ka fituar cilësinë *res judicata*, çdo vendimmarrje e pasigurt në favor të njohjes së këtij vendimi mund t’i cenonte shtetasit Sulejman Seferaj sigurinë juridike dhe të drejtën për liri e siguri të parashikuar nga neni 27 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 5 i KEDNJ-së.

27. Mbi bazën e ankimit të prokurorit, gjykata e apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë duke vendosur njohjen dhe dhënien fuqi për zbatim në Republikën e Shqipërisë të vendimit penal të huaj të Gjykatës së Apelit Bari, Itali të dhënë ndaj shtetasit shqiptar Sulejman Seferaj dhe konvertimin e dënimit të caktuar me këtë vendim sipas dënimeve të parashikuara nga ligji penal shqiptar për veprën “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të kryer në bashkëpunim në formën e organizatës kriminale, të parashikuar nga nenet 283, në lidhje me nenet 28, paragrafi 1, 333 dhe 334, paragrafi 1, të KP-së, me 6 vjet, 7 muaj e 7 ditë burgim. Sipas gjykatës së apelit, gjykata e shkallës së parë ka gabuar kur vendimmarrjen e saj e ka bazuar në dyshime. Nga ana tjetër, sipas saj, në rastin konkret nuk ekzistojnë pengesa ligjore për njohjen e vendimit penal të huaj objekt gjykimi.

28. Konkretisht, gjykata e apelit ka vlerësuar se nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Apelit Bari, Itali konstatohet se për shtetasin Sulejman Seferaj pasqyrohet fakti se ai ka qenë i lirë dhe nuk është paraqitur, ndërsa është mbrojtur nga avokati R.N. Po ashtu, në këtë vendim pasqyrohet se ky shtetas ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit dhe ka pasur dijeni për gjykimin. Sipas gjykatës së apelit, terminologjia e përdorur në vendimin penal të huaj dhe konkretisht “i lirë, nuk është paraqitur”, i korrespondon nenit 420 bis të Kodit të Procedurës Penale Italiane, analog me parashikimin e nenit 351 të KPP-së, që parashikon se i pandehuri është njoftuar, ka dijeni për gjykimin dhe nuk është paraqitur në mënyrë të vullnetshme. Për më tepër, arsyeton gjykata e apelit, në aktet bashkëlidhur kërkesës pasqyrohet se vetëm mbrojtësi i këtij shtetasi ka qenë i pranishëm edhe në përfundim të gjykimin, ndërsa mbrojtësit e të pandehurve të tjerë nuk janë paraqitur, duke u bërë zëvendësimi i tyre. Për rrjedhojë, gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se gjykimi ndaj shtetasit në fjalë ka qenë i rregullt, pasi ai është thirrur të paraqitet në gjykim dhe i është garantuar e drejta e mbrojtjes nga avokati i zgjedhur prej tij.

29. Po ashtu, gjykata e apelit ka vlerësuar se nuk ka dyshime që ekzekutimi i dënimit mund të jetë parashkruar sipas legjislacionit shqiptar. Në rastin konkret, arsyeton ajo, referuar dënimit të caktuar ndaj shtetasit Sulejman Seferaj me vendimin penal të huaj, afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit sipas nenit 68, shkronja “b”, të KPP-së, është 10 vjet. Ky afat, sipas saj, referuar raportit shpjegues të Konventës Evropiane “Për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjyqimeve penale” dhe praktikës gjyqësore të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, fillon nga dita kur vendimi penal i huaj është bërë final, pra kur ai ka fituar fuqinë *res judicata* dhe është bërë i përvokueshëm. Sipas gjykatës së apelit, nga certifikata e gjendjes së ekzekutimit rezulton se ndaj vendimit penal të huaj të Gjykatës së Apelit të Barit, Itali është paraqitur rekurs në Gjykatën e Kasacionit, që e ka shpallur të papranueshëm ankimin dhe, në vijim, është bërë shënimi se vendimi për të dënuarin Sulejman Seferaj është bërë i paapelueshëm, pra ka marr fuqinë e gjësë së gjykuar në datën 15.04.2014. Nisur nga kjo, sipas asaj gjykate, nuk ka ndonjë arsye për të vënë në diskutim saktësinë e informacionit zyrtar të autoriteteve gjyqësore italiane, ndërkohë që shtetasi Sulejman Seferaj nuk paraqet arsye/argumente konkrete që vënë në diskutim këtë informacion, çka të bënte të domosdoshëm kërkimin e një informacioni dhe dokumentacioni shtesë nga shteti kërkues. Për rrjedhojë, gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit në rastin konkret llogaritet nga dita kur vendimi penal i huaj është bërë i përvokueshëm, *res judicata*, pra nga data 15.04.2014 dhe, për pasojë, afati 10-vjeçar i parashkrimit plotësohet në datën 15.04.2024, ndërkohë që në datën e dhënies nga ajo të vendimit ky afat nuk është plotësuar.

30. Në lidhje me konvertimin sipas legjislacionit penal shqiptar të dënimit të caktuar ndaj shtetasit Sulejman Seferaj me vendimin penal të huaj të Gjykatës së Apelit Bari, Itali, gjykata e apelit ka vlerësuar se referuar nenit 516 të KPP-së dhe qëndrimin të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr. 5/2002, masa e dënimit që ajo duhet të caktojë për efekt ekzekutimi në Shqipëri të vendimit penal të huaj nuk mund të kalojë kufirin maksimal të parashikuar për të njëjtin fakt nga ligji shqiptar, nuk mund të rëndojë dënimin dhe se dënimi duhet t'i përgjigjet natyrës së vendimit penal të huaj. Mbështetur në këto kritere, duke mbajtur parasysh masën e dënimit që ligji shqiptar parashikon për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të kryer në bashkëpunim në formën e organizatës kriminale, të parashikuar nga nenet 283, paragrafi i parë (vepra dënohet nga 5 gjer në 10 vjet burgim), 28, paragrafi i parë, 333 dhe 334, paragrafi i parë, të KP-së (kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dënohet sipas dispozitave penale përkatëse, duke i shtuar dënimit edhe 5 vjet burgim), që varion nga 10 gjer në 15 vjet burgim, gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se ka përputhje të natyrës së dënimeve dhe se dënimi i caktuar ndaj shtetasit Sulejman Seferaj me vendimin penal të huaj është brenda kufijve minimalë dhe maksimalë të parashikuar nga legjislacioni shqiptar, prandaj ky vendim duhet të njihet dhe rrjedhimisht të zbatohet në Shqipëri e njëjta masë dënimi e mbetur pa vuajtur prej 6 vjetësh, 7 muajsh e 7 ditësh burgim.

31. Për rekursin e kërkuarit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij, duke i vlerësuar shkaqet e ngritura në të si haptazi të papranueshme/të pabazuara. Sipas asaj gjykate, pretendimet në rekurs kanë marrë përgjigje të gjerë dhe shteruese nga gjykata e apelit, ndërsa evidentohet se gjykimi në gjendje të lirë i shtetasit Sulejman Seferaj në Gjykatën e Apelit Bari, Itali është bërë në kushtet e njoftimit të tij, por se ai ka zgjedhur të mos paraqitet në gjykim, duke u mbrojtur nga avokati i zgjedhur prej tij, avokat i cili ka paraqitur rekurs për këtë shtetas, rekurs për të cilin, sikundër edhe për ato të disa prej të bashkëpandehurve të tjerë, Gjykata e Kasacionit e Italisë ka vendosur mospranimin. Po ashtu, sipas asaj gjykate, evidentohet se vendimi penal i huaj i Gjykatës së Apelit Bari, Itali në lidhje me shtetasin në fjalë, sipas legjislacionit procedural italian, ka fituar statusin *res judicata* dhe është bërë i ekzekutueshëm në përfundim të shqyrtimit të rekursit të tij nga Gjykata e Kasacionit e Italisë, pra në datën 15.04.2014, ndërkohë që ky vendim është ekzekutuar në datën 09.03.2023, ditën e arrestimit të tij në territorin shqiptar, pra brenda afatit 10-vjeçar të parashkrimit të ekzekutimit sipas nenit 68, shkronja “b”, të KPP-së.

32. Për sa më sipër, bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, si edhe referuar materialeve bashkëlidhur kërkesës, Kolegji vëren se vendimi i kundërshtuar i gjykatës së apelit

tregon mjaftueshëm rrethanat e çështjes, faktet e pranuar dhe përfundimet e nxjerra nga ajo, si dhe dispozitat ligjore në të cilat ajo është bazuar për zgjidhjen e çështjes në atë mënyrë. Ajo gjykatë ka vlerësuar provat dhe pretendimet e palëve, përfshirë edhe të kërkuesit, por në analizë të tyre dhe të ligjit të zbatueshëm ka çmuar se në rastin konkret nuk ekzistojnë pengesa ligjore për njohjen dhe ekzekutimin në Shqipëri të vendimit penal të huaj objekt gjykimi, ndërsa procesi gjyqësor i huaj ndaj kërkuesit ka qenë i rregullt dhe se ekzekutimi i dënimit sipas vendimit të gjykatës së huaj nuk është parashkruar.

33. Edhe vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i marrë në dhomën e këshillimit, në funksion të shqyrtimit paraprak të rekursit, tregon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në recurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, sikundër edhe arsyetimit të kufizuar në lidhje me to, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë tregon se pasi i ka vlerësuar ato, ka arritur në përfundimin se recursi i paraqitur nga kërkuesi është haptazi i pabazuar, pasi shkaqet e ngritura në të nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore. Ky vendimi nuk rezulton të jetë kontradiktor ose alogjik në përmbajtjen e tij.

34. Nga ana tjetër, për sa u përket pretendimeve të kërkuesit, që në thelb kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave dhe të interpretimit e zbatimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme, Kolegji vlerëson se ato nuk janë çështje që përfshihen në juridiksionin e Gjykatës, për sa kohë nga ai nuk argumentohet se zbatimi i ligjit nga ato ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Vetëm fakti se në përfundim të procesit gjyqësor, në të cilin palët kanë pasur mundësinë të ushtrojnë garancitë e tyre procedurale, gjykatat kanë dhënë një vendim jo në favor të kërkuesit, nuk është i mjaftueshëm për të provuar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

35. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.